



Në bazë të Programit për aktivitetet e Qytetit të Shkupit në fushën e arsimit të mesëm për vitin 2023 ("Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 18/22), dhe nenit 3 të Rregullores për ndarjen e bursave për nxënësit e shkollave të mesme me pengesa në zhvillimin psikik ose fizik, nxënës të shkollave të mesme të Qytetit të Shkupit me nr. 08-9957/1 data 29.09.2023, Qyteti i Shkupit shpall:

## **THIRRJE PUBLIKE PËR NDARJEN E BURSIVE PËR NXËNËSIT E SHKOLLAVE TË MESME ME PENGESA NË ZHVILLIMIN PSIKIK OSE FIZIK, NXËNËS TË SHKOLLAVE TË MESME TË QYTETIT TË SHKUPIT PËR VITIN SHKOLLOR 2023/2024**

### **I. PËRSHKRIMI I THIRRJES PUBLIKE**

Respektimi i diversitetit dhe përmirësimi i gjithëpërfshirjes së procesit arsimor janë thelbësore për arritjen e arsimit cilësor për të gjithë nxënësit, përfshirë edhe ata me pengesa në zhvillimin psikik ose fizik, si dhe për zhvillimin e komuniteteve gjithëpërfshirëse, paqësore dhe të drejta. Prandaj, përcaktimi i Qytetit të Shkupit është që me mbështetje financiare dhe logjistike të përkrahë iniciativa të ndryshme që garantojnë të drejtën e fëmijës për arsimim bazuar në mundësi të barabarta.

Në këtë drejtim është planifikuar realizimi i projektit "Bursa për nxënësit me pengesa në zhvillimin psikik ose fizik", qëllimi kryesor i të cilit është ngritja e cilësisë së arsimit për këtë kategori nxënësish. Gjatë kësaj, nxënësve me pengesa në zhvillimin psikik ose fizik nga shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit do t'u ndahen bursa në bazë të kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Rregulloren për ndarjen e bursave për nxënësit e shkollave të mesme me pengesa në zhvillimin psikik ose fizik, nxënës në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit.

### **II. KUSHTE PËR NDARJEN E BURSËS**

Të drejtë për bursë kanë kandidatët të cilët mësojnë në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit, dhe plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Të jenë nxënës të shkollave të mesme me pengesa në zhvillimin psikik ose fizik;
- Të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Të jenë banorë të Shkupit;
- Të jenë nxënës të rregullt në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit;

- Të jenë nxënës të rregullt të cilët gjatë vitit të kaluar shkollor kanë arritur sukses minimal prej **3,00**;
- Të mos jenë përfitues të bursave nga institucion, ndërmarrje ose organizatë tjetër gjatë vitit shkollor **2023/2024**;
- Të mos kenë përsëritur vitin gjatë shkollimit të tyre, me përjashtim të rasteve për arsye shëndetësore.

### III. VLERA E BURSËS

Vlera e bursës të cilën Qyteti i Shkupit e ndan për nxënësit e shkollave të mesme me pengesa në zhvillimin psikik ose fizik, nxënës në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit është **3.000** denarë në muaj (vlerë neto) me kohëzgjatje **9** muaj, dhe i referohet vitit shkollor **2023/2024**. Obligimi për llogaritjen dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat personale është i Qytetit të Shkupit.

Mjetet financiare do të paguhen në llogarinë e transaksionit të prindërit /kujdestarit/personi tjetër të autorizuar nga ana e aplikantit.

### IV. MËNYRA E SHPALLJES SË THIRRJES PUBLIKE

Thirrja publike shpallet në ueb faqen e Qytetit të Shkupit ([www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk)), në mediumet e shkruara (dhe atë të paktën në një gazetë ditore në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën që e flasin të paktën 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja) dhe në mediet elektronike.

Thirrja publike do të zgjasë **14** ditë kalendarike nga dita e shpalljes.

### V. KRITERE PËR NDARJEN E BURSAVE

Kriter për ndarjen e bursës është sukcesi në arsim.

Shkalla e pikëzimit të suksesit të arritur:

sukses mesatar	pikë
4,51 - 5,00	<b>100</b> pikë
4,01 - 4,50	<b>80</b> pikë
3,51 - 4,00	<b>70</b> pikë
3,00 - 3,50	<b>60</b> pikë

Në përzgjedhje do të përfshihen aplikantët të cilët në bazë të kriterëve do të vlerësohen me të paktën **60** pikë dhe maksimum **100** pikë.

Do të ndahen bursa për **25** nxënës.

## VI. MËNYRA E APLIKIMIT DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM

Aplikimi në Thirrjen publike realizohet me depozitim të dokumentacionit të mëposhtëm:

- Aplikim për ndarjen e bursave për nxënës të mesme në zhvillimin psikik ose fizik, nxënës në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit;
- Diagnozë dhe mendim për llojin dhe shkallën e pengesës së zhvillimit psikik ose fizik dhe nevoja specifike, të lëshuar nga institucioni kompetent, në përputhje me Rregulloren për vlerësimin e llojit dhe shkallës së pengesës së zhvillimit psikik ose fizik të miratuar nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 172/2016 dhe 41/2019);
- Kopje e shtetësisë së aplikantit;
- Kopje e kartës së identitetit të prindërit/kujdestarit/apo personi tjetër të autorizuar;
- Vërtetim se është nxënës i rregullt në vitin shkollor 2023/2024, të lëshuar nga shkolla e mesme;
- Kopje e dëftesës për vitin e kaluar shkollor të përfunduar, ku nxënësit e vitit të parë të arsimit të mesëm duhet të depozitojnë dëftesën e arsimit fillor nga klasa e 9-të;
- Deklaratë e nënshkruar nga prindi/kujdestari apo person tjetër i autorizuar me të cilën vërtetohet se aplikanti nuk është përfitues i bursës nga institucion, ndërmarrje ose organizatë tjetër gjatë vitit shkollor **2023/2024**;
- Vërtetim nga shkolla e mesme me të cilin vërtetohet se aplikanti nuk ka përsëritur vitin shkollor gjatë shkollimit të tij, me përjashtim të rasteve për arsye shëndetësore (që dëshmohet me dokumentacion përkatës mjekësor);
- Deklaratë për dhënien pëlqim për përpunimin e të dhënave personale.

**Aplikimi për ndarjen e bursave për nxënës të shkollave të mesme me pengesa në zhvillimin psikik ose fizik, nxënës në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit për vitin shkollor 2023/2024, Deklarata me të cilën vërtetohet se aplikanti nuk është përfitues i bursës nga institucion, ndërmarrje ose organizatë tjetër gjatë vitit shkollor 2023/2024, dhe Deklarata e dhënies pëlqim për përpunimin e të dhënave personale, janë në dispozicion në ambientet e Qytetit të Shkupit, në Sektorin e arsimit, Arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka 16) dhe në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk).**

Aplikimet duhet të depozitohen pranë Qytetit të Shkupit, nëpërmjet postës në adresën: Bul. "Ilinden" nr. 82, 1000 Shkup, ose në Arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka 16), më së voni **deri më 29.10.2023** deri në orën 19:00 të ditës së fundit të përfundimit të Thirrjes publike, me shënimin: **Për "THIRRJE PUBLIKE PËR NDARJEN E BURSIVE PËR NXËNËSIT E SHKOLLAVE TË MESME ME PENGESA NË ZHVILLIMIN PSIKIK OSE FIZIK, NXËNËS NË SHKOLLAT E MESME TË QYTETIT TË SHKUPIT PËR VITIN SHKOLLOR 2023/2024"**.

Aplikimet depozitohen në zarf të mbyllur dhe të vulosur me shënimin "Komisioni për zbatimin e procedurës për bursa për nxënës të shkollave të mesme me pengesa në zhvillimin

psikik ose fizik, nxënës në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit për vitin shkollor **2023/2024**“, pa cituar emrin e aplikuesit që depoziton aplikimin.

Aplikimet e parregullta të cilat nuk janë depozituar në mënyrën e përcaktuar në tekstin e mësipërm, gjegjësisht që përmbajnë të dhëna të paplota dhe dokumentacion të pakompletuar, si dhe aplikimet të cilat nuk do të depozitohen në afatin e caktuar, nuk do të shqyrtohen.

## **VII. MËNYRA E VLERËSIMIT**

Për realizimin e kësaj Thirrjeje publike, kryetarja e Qytetit të Shkupit do të formojë Komisionin për zbatimin e procedurës për ndarjen e bursave për nxënësit e shkollave të mesme me pengesa në zhvillimin psikik ose fizik, nxënës të shkollave të mesme të qytetit të Shkupit, për vitin shkollor 2023/2024, i cili do të jetë i ngarkuar për vlerësimin e kërkesave të pranuar sipas Rregullores për ndarjen e bursave për nxënës të shkollave të mesme me pengesa në zhvillimin psikik ose fizik, nxënës të shkollave të mesme të Qytetit të Shkupit për vitin shkollor 2023/2024, e cila është shpallur në ueb faqen e Qytetit të Shkupit [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk).

## **VIII. MËNYRA DHE AFATI I DEPOZITIMIT TË APLIKIMEVE**

Thirrja publike do të shpallet më **16.10.2023** dhe do të zgjasë deri më **29.10.2023**.

Aktvendimi për kandidatët e përzgjedhur do të shpallet në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk)

Informacione plotësuese mund të merren në telefonin **02/3297-319**.

**QYTETI I SHKUPIT**